REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1776/2 Prot.

Vlorë, më 12/10/2026

VENDIM

"Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori - subjekti "Rema Gjikopulli" p.f me NUIS L87210202C, me ushtrim të aktivitetit në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë".

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.116, me Nr.1175 Prot., datë 15/06/2026, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 38,132 (tridhjet e tetëmijë e njëqind e tridhjet e dy) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor, si dhe penalitetit doganor në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 76,264 (shtatëdhjet e gjashtëmijë e dyqind e gjashtëdhjet e katër) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor "Rema Gjikopulli" p.f, me NUIS L87210202C, me ushtrim të aktivitetit në Vlorë (Lagjja "29 Nëntori", Rruga "Vasil Bifsha", Objekt Nr.7; Nr. Tel : 682152143), me status në QKB "Aktiv". Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor "Rema Gjikopulli" p.f, me NUIS L87210202C me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.1786/1 Prot., datë 17/06/2026, me lëndë "Njoftim Vendimi", por rezulton se zarfi me kod bar RR838976070AA është rikthyer në doganë me shënimin postar "I Panjohur".

Më tej, Dega e Doganës Vlorë ka vijuar me kryerjen e lajmërimit (njoftimit) publik me shkresat : Nr.2210 Prot., datë 24/07/2026, me "*Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)*", drejtuar Bashkisë Vlorë, e cila ka kryer konfirmimin e shpalljes publike me shkresën e saj nr.15393/1 Prot., datë 03/08/2026, me lëndë "Mbi kërkesën për konfirmim të shpalljes publike", e cila është administruar në doganë me nr.2210/1 Prot., datë 10/08/2026;

Nr.2211 Prot., datë 24/07/2026, me "*Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)*", drejtuar Prefektit të Qarkut Vlorë, i cili ka kryer konfirmimin e shpalljes publike me shkresën e Tij nr.1072/1 Prot., datë 31/08/2026, me lëndë "Mbi shpalljen publike të aktit administrativ", e cila është administruar në doganë me nr.2480/1/1 Prot., datë 03/09/2026;

Nr.2212 Prot., datë 24/07/2026, me "*Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)*", drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, i cili ka kryer afishimin me shkresën nr.14489 Prot., datë 29/07/2026;

Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me njoftimin elektronik të vendimit, me email-in e datës 25/08/2026, ora 20:05, me lëndë "Rinjoftim akti administrativ (Vendimi Nr.116, me Nr.1175 Prot.,

datë 15/06/2026). Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar me shkresën Nr.2555 Prot., datë 25/08/2026 me lëndë "Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore"; me email-in e datës 27/08/2026 me lëndë "Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore"; me shkresën Nr.2555/1 Prot., datë 18/09/2026 me lëndë "Rikërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore"; me email-in e datës 26/09/2026 me lëndë "Rikërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore"; me anë të së cilës, Dega e Doganës Vlorë i ka rikërkuar subjektit debitor ekzekutimin vullnetar edhe të aktit administrativ të lartcituar.

Personi juridik debitor "Rema Gjikopulli" p.f, me NUIS L87210202C, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.116, me Nr.1175 Prot., datë 15/06/2026, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor. Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.116, me Nr.1175 Prot., datë 15/06/2026, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti "Rema Gjikopulli" p.f, me NUIS L87210202C, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*,

V E N D O S A :

• Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - "Rema Gjikopulli" p.f, me NUIS L87210202C, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.

• Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "Rema Gjikopulli" p.f, me NUIS L87210202C, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.

• Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik "Rema Gjikopulli" p.f, me NUIS L87210202C, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale **114,396** (Njëqind e katërmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr.116, me Nr.1175 Prot., datë 15/06/2026, të Degës së Doganës Vlorë.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj